

VENDIM
Nr. 463, datë 22.6.2016

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK NË
KOPLIK, MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 61 (gjashtë-dhjetë e një) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 2220, në Koplik, Malësi e Madhe, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë që do të zhvillohen në këtë zonë janë të llojit:

- a) prodhuese, industriale dhe agropërpunimi;
- b) tregtare dhe magazinimi mallrash;
- c) shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet.

5. Zona e teknologjisë dhe e zhvillimit ekono-mik jepet me qira, me çmimin 1 euro.

6. Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

7. Kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohen zhvilluesit, janë:

- a) propozimi i projektit teknik;
- b) ndikimi mjedisor;
- c) ndikimi social;
- c) kohëzgjatja e punimeve;
- d) kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

8. Vendimi nr. 12, datë 4.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës ekonomike në Koplik, Shkodër”, dhe vendimi nr. 773, datë 4.6.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Koplik, Shkodër, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgje-dhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, shfuqi-zohen.

9. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK”, KOPLIK, MALËSI E MADHE**

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m²	Statusi i pronësisë
1	2220	201/8	Arë	985	Shtet
2	2220	193	Arë	27,573	Shtet
3	2220	194	Arë	20,978	Shtet
4	2220	163	Arë	30,382	Shtet
5	2220	160	Arë	63,199	Shtet
6	2220	161	Arë	86,998	Shtet
7	2220	159	Arë	24,004	Shtet
8	2220	200	Arë	86,417	Shtet
9	2220	195/1	Kullotë	49,321	Shtet
10	2220	157	Arë	19,882	Shtet
11	2220	158/1	Arë	19,124	Shtet
12	2220	187/2	Arë	55,941	Shtet
13	2220	185/4	Kullotë	99,231	Shtet
14	2220	192	Arë	22,000	Shtet
15	2220	201/9	Arë	4,004	Shtet
				610,039	SHUMA

HARTA E “ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”
KOPLIK, MALËSI E MADHE, SIPËRFAQJA 61 HA



